



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKT- REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN E
DOSJEVE TË ISH SIGURIMIT TË SHTETIT
PËR VITIN 2019**

Kuvendi i Shqipërisë

- Duke patur parasysh që, AIDSSH ka detyrimin ligjor të verifikimit të pastërtisë së figurave të zyrtarëve të lartë, proces që përfshin shumë institucione dhe synon rritjen e profesionalizmit, konsolidimin e pavarësisë e paanësisë dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet.
- Duke patur parasysh që, zbardhja e së vërtetës së krimeve të rregjimit komunist përmes fakteve dhe dokumentave është mënyra më mirë për ti shërbyer historisë si dhe ndërgjegjësimit dhe informimit qytetar mbi kujtesën e viktimave të totalitarizmit, përkujtimin e të zhdukurve dhe nderimin e të mbijetuarve, kjo gjë arrihet vetëm përmes angazhimit aktiv dhe marrjes së përgjegjësiwe institucionale nga AIDSSH.
- Duke patur parasysh që, AIDSSH e zhvillon veprimtarinë e vet me vetëdije për historinë dhe përgjegjësi për të ardhmen, në respekt të vlerave evropiane e properëndimore, ku njohja dhe rritja e vetëdijes për trashëgiminë e përbashkët evropiane të krimeve të kryera nga diktaturat komuniste, naziste e të tjera, kanë rëndësi jetike për unitetin e Europës.
- Duke patur parasysh që, në shtator 2019, Parlamenti Europian miratoi rezolutën mbi rëndësinë e një kujtese të përbashkët evropiane, duke shprehur respekt për secilën viktimë të sistemeve totalitare, mbështetje për përkujtimin dhe shqetësim për përdorimin e simboleve të regjimeve dhe glorifikimin e tyre.
- Duke pasur parasysh që kujtimet e së kaluarës tragjike të Europës duhet të mbahen gjallë, në mënyrë që të nderohen viktimat, të dënohen autorët dhe të shtrohet rruga për pajtim, bazuar tek e vërteta dhe përkujtimi.
- Duke patur parasysh që studimi i plotë dhe i thelluar i burimeve arkivore autentike të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit është një proces i gjatë dhe i vazhdueshëm.

Kuvendi i Shqipërisë shqyrtoi veprimtarinë e Autoritetit për Informimin e Dosjeve të Ish- Sigurimit të Shtetit për vitin 2019 dhe vlerësoi:

- Punën e bërë nga AIDSSH në vlerësimin e kandidatëve/zyrtarëve përpara emërimit apo ngritjes në detyrë, kur kjo është kërkuar nga institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike, megjithëse përgjatë vitit 2019, AIDSSH ka ushtruar funksionet me staf të paplotësuar, dhe arkivi ka vijuar të jetë i lokalizuar në dy godina të ndryshme, duke sjellë vështirësi, sa i takon cilësisë së shërbimit, kushteve të përshtatshme të punës dhe studimit, shërbimit të dokumenteve arkivore dhe vënies në dispozicion në kohë të shkurtër.
- Punën e bërë nga AIDSSH, si dhe bashkëpunimi me Komisionin Ndërkombëtar të Personave të Zhdukur (International Commission on Missing Persons) ICMP lidhur me procesin e identifikimit nëpërmjet vënies në dispozicion, të dokumenteve arkivore

të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit që lidhen me vendekzekutimet dhe me vendvarrimet masive gjatë regjimit komunist.

- Propozimet e bëra nga AIDSSH lidhur me rivlerësimin dhe nderimin e personaliteteve të panjohur më parë të cilët kanë vuajtur dënime, janë persekutuar e pushkutatuar gjatë periudhës së rregjimit komunist, si dhe për kthimin në vende kujtese të Kampit të Tepelenës dhe të Mënikut në Pezë (ku u zhvarrosën eshtrat e 22 intelektualëve të pushkatuar pa gjyq më 26 shkurt 1951)
- Punën e bërë nga AIDSSH në realizimin e një sërë aktiviteteve si dhe botime të ndryshme me qëllim ndërgjegjësimin dhe informimin qytetar mbi kujtesën e viktimave të totalitarizmit, nderimin dhe përkujtimin e tyre si dhe pasqyrimin e aktiviteteve të institucionit në faqen zyrtare dhe rrjete të ndryshme sociale.
- Punën e bërë nga AIDSSH gjatë vitit të kaluar për gjetjen e mjeteve të financimit nga donatorë potencialë e cila është konkretizuar me nënshkrimin e marrëveshjes me Qeverinë Suedeze për rikonstruksionit e godinës (përfshi blerjen e pajisjeve TIK për krijimin e një arkivi të integruar sëbashku me paisjet e nevojshme për arkivën).
- Punën e bërë nga AIDSSH gjatë vitit të kaluar lidhur me përmirësimin e procesit të verifikimit të të dhënave, me qëllim nxjerrjen e vendimeve që përmbajnë të dhëna të sakta.
- Punën e bërë nga AIDSSH gjatë vitit të kaluar për miratimin e “Rregullore e publikimit të veprimtarisë së Autoritetit në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj” qëllimi i së cilës është nga njëra anë publikimi i veprimtarisë së Autoritetit në faqen zyrtare dhe përmes buletinit, dhe nga ana tjetër përcaktimi i procedurave organizative dhe teknike, si dhe marrja e masave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurisë së tyre. (proces i cili është konsultuar edhe me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale)
- Shkëmbimn e përvojave me institucione homologe të vendeve ish-komuniste si një mënyrë efikase për tu njohur konkretisht me të gjitha fazat nëpër të cilat po kalon aktualisht AIDSSH dhe për të përfituar nga përvoja e tyre në përmbushjen e misionit të Autoritetit dhe përballjen me sukses të sfidave të reja.

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Autoritetit për Informimin e Dosjeve të Ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2020, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj të angazhohet veçanërisht dhe në këto drejtime:

- Të japë kontribut konkret dhe të bashkëpunojë me të gjithë aktorët dhe faktorët e shoqërisë shqiptare në mënyrë që mbështetur në dëshmi dhe dokumente arkivore mbi krimet e komunizmit, të zbulohen histori të të zhdukurve dhe hidhet dritë mbi figura dhe personalitete frymëzuese, të panjohur më parë për shoqërinë shqiptare si dhe të ndërmarrë nisma konkrete për nderimin e Viktimave të Regjimit Totalitar dhe organizimin e aktiviteteve të ndryshme në përkujtim të tyre.
- Duke qenë se krijimin i një arkivi të vetëm të gjithë dokumenteve të ish-Sigurimi i Shtetit, është i një rëndësie të vecantë për trashëgiminë historike kombëtare, dhe vijon të mbetet një ndër sfidat e rëndësishme të Autoritetit pasi procesi i marrjes në dorëzim të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit nga ASMB (Arkiva e Sistemit të Ministrisë së Brendshme) është pothuajse i bllokuar që nga muaji maj 2019, ndërkohë që edhe veprimtaria e AIDSSH varet dhe bazohet në dokumentet arkivore, AIDSSH të marrë masa që për zgjidhjen e kësaj situate, krahas vijimit të komunikimit me Ministrinë e Brendshme të shfrytëzojë “Platformën Ndërinstitucionale Online” të ngritur nga Kuvendi i Shqipërisë e cila është në dispozicion të institucioneve të pavarura si një mjet i ri i cili synon rritjen e autoritetit të Institucioneve të Pavarura si dhe përfshirjen e Kuvendit të Shqipërisë si katalizator ndërmjet institucioneve të pavarura dhe atyre qeveritare.

- T'i kushtojë një rëndësi të vecantë digjitalizimit të dokumentave arkivore duke mbajtur në vëmendje që formatet përkatëse të jenë të përshtatshëm (compatibel) për ngritjen e një Data Baze të kompjuterizuar nëpërmjet së cilës, përdoruesit do të kenë mundësi kërkimi dhe shfrytëzimi të dokumenteve arkivore të krijuara nga strukturat e ish-Sigurimit të Shtetit, në të njëjtën kohë digjitalizimi i dokumentave arkivore ndikon drejtpërdrejtë në ruajtjen dhe në sigurinë e dokumentave origjinale dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi.
- Të intensifikojë bashkëpunimin në forma të ndryshme me shoqatat e ish të përndjekurve politike, në mënyrë të vecantë me të mbijetuar (ish të përndjekur) të rregjimit komunist të cilët janë dëshmitarë të gjallë të krimeve të kryera gjatë periudhës së errët komuniste me qëllim ndërgjegjësimin dhe informimin qytetar për kujtesën e viktimave të regjimeve totalitare dhe autoritare, përkujtimin dhe vlerësimin e të zhdukurve, nderimin e të mbijetuarve si dhe marrjes së dëshmive dhe fakteve lidhur me vendvarrimeve të mundshme të të pagjeturve.
- Të mos mjaftohet vetëm me dërgimin e kërkesës bashkive përkatëse por të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e procesit dhe zbatimin nga ana e bashkive të ndryshme shenjimin e vendvarrimeve të mundshme të të pagjeturve në territorin e saj administrativ dhe njëherazi, të vendosë në mbrojtje (mbikëqyrje të posaçme) vendet e internimit, kampet e punës dhe burgjet e rregjimit komunist konform edhe Rezolutës përkatëse të Kombeve të Bashkuara dhe të bëjë propozime konkrete për përmirësime ligjore për të koordinuar më mirë punën mbi të zhdukurit, mes institucioneve, qeverisjes vendore, prokurorisë dhe familjeve.
- Të bëjë propozime dhe ndryshime të nevojshme në mënyrë që vendimet e marra të jenë sa më të drejta dhe ku të jenë të përfshira në mënyrë sa më të saktë të gjitha të dhënat mbi subjektet përkatës.
- Inkurajon AIDSSH që krahas vijimit të aktiviteteve e botimeve të gjejë mundësi dhe rrugë të reja bashkëpunimi me qëllim rritjen e ndjeshmërisë publike ndaj krimeve të komunizmit në ndihmë të shoqërisë e brezave të rinj, si dhe rritjen e transparencës dhe sqarimit të opinionit publik lidhur me këto krime.
- Të organizojë më mirë punën për realizimin në kohë të procedurave të prokurimit në mënyrë që fondet e akorduara nga buxheti i shtetit për investime të shkrytëzohen plotësisht, dhe në të njëjtën kohë inkurajon AIDSSH që të vijojë përpjekjet për gjetjen e donatorëve të ndryshëm që janë të gatshëm të financojnë projekte në këtë fushë.
- Pas miratimit dhe vënies në dispozicion, në tetor 2019, të një shtese prej 10 punonjësish të rinj AIDSSH të vijojë pa humbur kohë procedurat e rekrutimit për plotësimin e të gjithë vendeve vakante në strukturë gjë e cila do ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, uljen e kohës së pritjes dhe rradhëve të gjata me të cilat Autoriteti është përballur për shkak të funksionimit me staf të paplotësuar.
- Të propozojë ndryshimet e nevojshme të kuadrit ligjor të cilat ndikojnë në përmbushjen me sukses të misionit të AIDSSH-së dhe krijojnë mundësinë për një produkt sa më cilësor në veprimtarinë e përditshme të institucionit.
- Të punojë për organizimin e veprimtarive të rëndësishme, sipas kalendarit të kujtesës, të mbështetura nga bashkëpunëtorë dhe institucione të memories, duke i propozuar Qeverisë Shqiptare vendimet përkatëse për projektin dyvjeçar #Demokraci 30.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratohet, në datë _____

[shqiptarja.com]